



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:261751
Datë: 27.08.2021
Numri i dokumentit: 02122812

A.nr.1028/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, në konfliktin administrativ të paditëses L.M.N. nga Peja të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokatja Q.L. nga Ferizaj, kundër të paditurës së parë Agjencia Kadastrale e Kosovës si dhe kundër të paditurës së dytë Komunës së Pejës, për shkak të anulimit të Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Pejës-Divizioni për çështje pronësore juridike me nr. të protokollit 1-463/274 7809 i datës 02.10.2009, aktvendimi plotësues i Kuvendit të komunës së Pejës nr. 01-400-5084 i datës 31.07.2012, konkluzioni i Drejtorit të Drejtoratit për pronësi e gjeodezi dhe kadastër në Pejë me nr. LP-88/11 i datës 14.12.2012, si dhe aktvendimit-përgjigjjes së Agjencionit Kadastral të Kosovës me nr.03/619/16 (03/802/16) e datës 14.06.2016, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 11.08.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses L.M.N. nga Peja të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokatja Q.L. nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të anulohet konkluzioni i Drejtorit të Drejtoratit për pronësi e gjeodezi dhe kadastër në Pejë me nr. LP-88/11 i datës 14.12.2012, aktvendimi plotësues i Kuvendit të komunës së Pejës nr. 01-400-5084 i datës 31.07.2012 si dhe përgjigjja në kërkesë e Agjencionit Kadastral të Kosovës me nr.03/619/16 (03/802/16) e datës 14.06.2016.

II. HUDHET poshtë si i palejuar propozimi i paditëses për anulimin e Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Pejës- Divizioni për çështje pronësore juridike me nr. te protokollit 1-463/274 7809 i datës 02.10.2009.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt në pajtim me nenin 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse e në mungesë të palëve të paditura të ftuara në mënyrë të rregullt. Në seancën e shqyrtimit kryesor, prezent ishte edhe përkthyesja gjyqësore B.B..

Paditësja me padinë e datës 06.07.2016, pohon se posa kishte kuptuar ndryshimin e gjendjes kadastrale dhe juridike lidhur me patundshmërinë e saj, i ishte drejtuar organit komunal në Pejë që t'ia dorëzoj vendimin për ndryshimin e titullarit, ku i njëjti me datë 19.05.2016, për herë të parë paditëses ia dorëzon në formë të shkruar këto vendime.

Sipas Konkluzionit të Drejtoratit për çështje pronësore juridike të datës 14.12.2012, i njëjti rezulton se Drejtoria për çështje Pronësore-juridike sipas Aktvendimit plotësues të Asamblesë Komunale në Pejë nxjerr konkluzion me të cilin në pikën I bën përshtetjen e aktvendimeve të sipër përmendura, në pikën II bën ndarjen fizike të këtyre ngastrave ndërsa në pikën III bën ndryshimin e regjistrave të këtyre ngastrave kadastrale më përafërsisht si në dispozitivin e këtij Konkluzioni si në pikën I, II, III të këtij konkluzioni. Paditësja poashtu pohon se kundër këtyre vendimeve paditësja ushtron ankesë në Agjencionin Kadastral të Kosovës i cili përmes përgjigjjes e shpall veten inkompetent për të vendosur në lidhje me ankesën.

Paditësja poashtu shton se sa i përket Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Pejës- Divizioni për çështje pronësore juridike me nr. të protokollit 1-463/274 7809 i datës 02.10.2009, aktvendimi plotësues i Kuvendit të komunës së Pejës nr. 01-400-5084 i datës 31.07.2012, konkluzioni i Drejtorit të Drejtoratit për pronësi e gjeodezi dhe kadastër në Pejë me nr. LP-88/11 i datës 14.12.2012, konsiderojmë se të njëjtat janë të kundërligjshme ngase nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore, akti është nxjerrë nga organi jokompetent, për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike;

1.4. për shkak se me aktin përfundimtar administrativ i nxjerrë sipas vlerësimit të lirë, organi i ka tejkaluar kufijtë e autorizimit ligjor ose akti i tillë nuk është nxjerrë në pajtim me qëllimin e këtij ligji. Paditësja poashtu pohon se të paditura kanë shkëlur nenin 3, 4, 5, 6 të LPA-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e paditëses deklaroi: *“Mbesim ne tersi pran padisë dhe kërkesë padis, si dhe pran parashtrimeve tona te potencuara nga seancat paraprake duke shtuar se pran kësaj gjykate ja kemi dorëzuar te gjitha provat që ne i posedojmë e qe kanë te bëjnë me çështjen në procedure, e të cilat dëshmojnë bindshëm bazueshmerin e kërkesë padis, e duke pas parasysh që nuk kemi prova tjera që të prezantojmë i propozojmë gjykatës që të kalojmë në procedurën për administrimin e provave dhe pastaj në fjalën përfundimtare”*.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Mbesim në tersi pran padisë dhe kërkesë padis si dhe pran parashtrimeve tona te potencuara nga seancat paraprake, duke shtuar se konsiderojmë bindshëm se me provat e administruara u vërtetua bazueshmeria e kërkesë padisë . Për shkak*

te ekonomizimit te procedurës fjalën përfundimtare me detajisht e kemi formuluar me parashtrësë me shkrim te cilën ja dorëzoj gjykatë tani drejt persëdrejti. Për me tepër i propozoj gjykatës që te anulohen ç fuqizohen aktvendimi i kryetarit te komunës se Pejës divizioni për çështje pronësore juridike me nr. te protokollit 1-463/274 7809 i dt. 02.10.2009, si dhe aktvendimi plotësues i Kuvendit te komunës se Pejës nr. 01-400-5084 i dt. 31.07.2012 si dhe konkluzioni i drejtorit te drejtoratit për pronësi e gjeodezi dhe kadastër ne Pejë me nr. LP - 88/111 dt. 134.12.2012, si dhe aktvendimi-përgjigjja e te paditurës se pare AKK, e dt. 14.06.2016 me nr. 03/619/16 (03/802/16)”. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, paditësja deklaroi se: “sa i përket Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Pejës- Divizioni për çështje pronësore juridike me nr. të protokollit 1-463/274 7809 i datës 02.10.2009, aktvendimi plotësues i Kuvendit të komunës së Pejës nr. 01-400-5084 i datës 31.07.2012, konkluzioni i Drejtorit të Drejtoratit për pronësi e gjeodezi dhe kadastër në Pejë me nr. LP-88/11 i datës 14.12.2012, konsiderojmë se të njëjtat janë të kundërligjshme ngase nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore, akti është nxjerrë nga organi jokompetent, për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike;

1.4. për shkak se me aktin përfundimtar administrativ i nxjerrë sipas vlerësimit të lirë, organi i ka tejkualuar kufijtë e autorizimit ligjor ose akti i tillë nuk është nxjerrë në pajtim me qëllimin e këtij ligji. I propozon Gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse ta aprovoj si të bazuar ngase të paditurat kanë vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore të potencuara si në referatin e kërkesëpadisë”.

E paditura e parë Agjencia Kadastrale e Kosovës me përgjigjjen në padi të datës 04.02.2019 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke theksuar se: “AKK-ja pas shqyrtimit të ankesave konstatoi se nuk është kompetente për shqyrtimin e vendimeve të lëshuara nga Zyra e Kryetarit të Komunës, gjegjësisht Divizioni për Çështje Pronësore Juridike. Rrjedhimisht AKK pas shqyrtimit të ankesave të palës, shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 6.1 të Ligjit me nr. 2002/5 për Themelimin e RDPP-së konsideron se nuk është kompetente për shqyrtimin e ankesave tuaja. AKK-ja sipas dispozitave ligjore në fuqi të Ligjit nr. 04/L-013 Për Kadastër dhe Ligjit me nr. 2002/5 për Themelimin e RDPP-së, neni 5 i Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër), ndërsa AKK si autoritet qendror bën rishqyrtimin e vendimeve të nxjerra nga Zyrat Kadastrale Komunale lidhur me mbarëvajtjen e regjistrimit në kadastër (nenin 6 i Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e RDPP-së dhe neni 28 të Ligjit nr.04/L-013 për Kadastër) dhe jo të vendos rishqyrtimin e kërkesave juridike pronësore, andaj i propozon Gjykatës që të nxjerr Aktgjykim me të cilin refuzon padinë e paditëses si të pabazuar dhe vërteton përgjigjjen me nr. 03/619-802/16 të datës 14.06.2016 të lëshuar nga AKK”.

E paditura e dytë, komuna e Pejës, me përgjigjjen në padi të datës 06.04.2017 ka pohuar se “nga pretendimet e lartëcekura rrjedh se për të njëjtën patundshmëri pala paditëse e ka inicuar procedurën kontestimore në Gjykatën Themelore në Pejë me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronare në patundshmërinë e lartëcekur mirëpo për të njëjtën çështje e ka inicuar edhe procedurën administrative duke kërkuar që të vërtetohet se është pronare në të njëjtën patundshmëri sipas bazës së njëjtë juridike sipas së cilës e ka kërkuar njohjen e të drejtës së pronësisë edhe në procedurën kontestimore, prandaj i kishte propozuar Gjykatës që të ndërprehet procedura administrative derisa të përfundoj procedura kontestimore”.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi i Komunës e Pejës me nr. protokollin 15463-50500/2016 i dt 17.05.2016, konkluzioni i Komunës e Pejës nr. LP-88/11 i dt. 14.12.2012, vendimi plotësueses i Komunës e Pejës me nr. 400-5084 i dt. 31.07.2012, certifikata e Komunës së Pejës nr. 01-3/1560 i dt. 19.10.2001, kërkesa për vendim nr.15/463 /35313 i dt. 16.03.2016, kërkesa për plotësimin e lëndës e dt.27.05.2016.

Lexohet: Përgjigja ne kërkesë e dt. 14.06.2016, certifikata e AKK e dt. 05.04.2011, ekspertiza gjyqësore nen shenjën C.nr. 155/12 e dt. 20.09.2013, fleta poseduese nr. 2132 e dt. 18.11.2003, aktvendimi i Komunës e Pejës me nr. protokollin I-463/27478/09 dt. 02.10.2009, aktvendimi i Gjykatës se Apelit nen shenjën AC.nr.1149/2016 i dt. 25.09.2020, vendimi mbi trashëgimin e Gjykatës Komonale ne Pejë nr. 1/05 dt. 12.01.2005, përgjigja e avokatit publik te Komunës me nr. 261/79 i dt. 20.06.1979, shkresa e sekretariatit te urbanizmit nr. 329/84 dt. 25.12.1984, shkresa e kuvendit Komunal nr. 04-09 e dt. 17.10.1967, shkresa e Departamentit për pune Komonale – vlerësimi i paluejtshmerisë nr.12071/1 -958 dt. 06.11.1958, shkresa e sigurimit social nr. 04-12071/58 dt. 25.08.1962, fleta poseduese nr. 2324 i vitit 2007, parashtrësia E Komunës e Pejës e dt. 26.04.2021, vendimi nr. 03-14844/1-1958 i dt. 31.01.1959, fletëpagesa e dt. 20.03.1959, faturimi nr. 12075 /1 i dt. 25.10.1958, shkresa e këshillit shoqëror për plan dhe financa e dt. 06.02.1958, kontrata e shitblerjes (data nuk shihet), aktvendimi me nr. 03-10925 i dt. 28.07.1959, raporti për pagesën e te hollave sipas obligimeve sipas kontratës nr. 8376/57 i dt. 17.10.1967, aktvendimi nr. 03-4108/1 dt. 19.03.1959 si dhe lista e posedimit i dt. 20.05.1967.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve dhe akteve tjera të goditura me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar.

Gjykata gjeti se si Konkluzioni i Drejtorit të Drejtoratit për pronësi e gjeodezi dhe kadastër në Pejë me nr. LP-88/11 i datës 14.12.2012, ashtu edhe Aktvendimi plotësues i Kuvendit të komunës së Pejës nr. 01-400-5084 i datës 31.07.2012 si dhe përgjigjja në kërkesë e Agjencionit Kadastral të Kosovës me nr.03/619/16 (03/802/16) e datës 14.06.2016 janë marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se të njëjtat në asnjë rrethanë nuk përmbajnë as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Gjykata gjeti se e paditura e parë Agjencia Kadastrale e Kosovës, me të drejtë ka dhënë përgjigje në kërkesë me nr.03/619/16 (03/802/16) e datës 14.06.2016 dhe me të drejtë e ka shpallur veten inkompetente për të vendosur në lidhje me ankesën. Këtë qëndrim të të paditurës së dytë, gjykata e mbështeti duke u bazuar në nenin 6.1 të Ligjit me nr. 2002/5 për Themelimin e RDPP-së. Poashtu gjykata ju referua edhe Ligjit nr. 04/L-013 Për Kadastër dhe Ligjit me nr. 2002/5 për Themelimin e RDPP-së, neni 5 i Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër), ku AKK si autoritet qendror bën rishqyrtimin e vendimeve të nxjerra nga Zyrat Kadastrale Komonale lidhur me mbarëvajtjen e regjistrimit në kadastër (nenin 6 i Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e RDPP-së dhe neni 28 të Ligjit nr.04/L-013 për Kadastër) dhe nuk vendos rishqyrtimin e kërkesave juridike pronësore.

Gjykata refuzoi pretendimet e paditëses për t'u urdhëruar Drejtorati për Çështje Pronësore Juridike në Pejë që paditëses t'ia njoh të drejtën e pronësisë, për faktin që nuk është në kompetencë të kësaj Gjykate që të trajtoj pretendime ankimore të cilat bien në fushëveprimin e gjykatës civile.

Gjykata i mbështeti si plotësisht të drejta dhe të ligjshme arsyet mbi bazën e të cilave është marrë Konkluzioni i Drejtorit të Drejtoratit për pronësi e gjeodezi dhe kadastër në Pejë me nr. LP-88/11 i datës 14.12.2012, ashtu edhe Aktvendimi plotësues i Kuvendit të komunës së Pejës nr. 01-400-5084 i datës 31.07.2012. Në lidhje me këtë, gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material, dispozitat procedurale të procedurës administrative si dhe ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike.

Në lidhje me propozimin e paditëses për t'u anuluar Aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Pejës-Divizioni për çështje pronësore juridike me nr. te protokollit 1-463/274 7809 i datës 02.10.2009, gjykata ju referua Ligjit për Konfliktet Administrative, përkatësisht nenit 9, i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*.

Ndërsa me nenin 10, paragrafin 1 të po të njëjtit Ligj, përcaktohet se: *“1. Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor”*.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dhe duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendimi i të paditurës së dytë Aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Pejës-Divizioni për çështje pronësore juridike me nr. te protokollit 1-463/274 7809 i datës 02.10.2009, me të cilin në Këshillën Juridike thuhet se: *“Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 ditësh që nga dita e marrjes së këtij Aktvendimi. Ankesa i Drejtohet Agjencionit Kadastral të Kosovës në Prishtinë”*, nuk është vendim përfundimtar në procedurën administrative, prandaj mbi këto arsye, Gjykata vlerësoi se në raport me këtë lloj të vendimit, nuk mund të hapet konflikti administrativ me padi.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerëson se vendimet e goditura me padi janë të drejta dhe të bazuara në gjendjen e vërtetuar faktike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditëses, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i kanë provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurave e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj Gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, të paditurat drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur kanë vendosur dhe përgjigjur me aktet administrative të kontestuara nga paditësja. Mbi këto

arsye thëniet e paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga të paditurat.

Vendimi në lidhje me shpenzimet e procedurës, u mor në bazë të nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6, 9, 15, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, nenit 34, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.5 si dhe nenit 38 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 1028/18, datë 11.08.2021

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj